

EUROPA

DREJTOR: ALBERT RAKIPI • KRYEREDAKTOR: JORGJI QIRJAKO • SHEFE E MARREDHENIEVE ME JASHTË: SABINA YMERI

Një ditë e mirë për Europën

27 krerët e shteteve dhe të qeverive të BE-së u takuan në Bruksel nga 21 deri 23 qershor



Gjatë presidencës së saj të këshillit, qeveria gjermane i caktoi vetes synimin e forcimit të transparencës dhe efektivitetit të BE-së, nxitjes së vendimeve konkrete në dobi të qytetarëve evropianë dhe ja doli me sukses. Eurobarometri më i fundit tregon, në mënyrë mbresëlënëse, se në fund të presidencës gjermane qëndrimi pozitiv ndaj BE-së ka arritur nivelin më të lartë në 10 vjet. Rreth 57 % e qytetarëve të BE-së mendojnë se anëtarësimi në BE i vendit të tyre është një gjë e mirë. Në të njëjtën kohë, në BE u morën një numër i madh vendimesh të rëndësishme. Lista e përgjithshme pozitive e presidencës gjermane mund të përmbledhet në pesë fusha qendrore:

1. Miratimi i Deklaratës së Berlinit dhe marrëveshja për reformën e traktatit, gjë që do të thotë se aftësia e BE-së për të vepruar është siguruar në mënyrë afatgjatë. Në Këshillin Evropian të qershorit, krerët e shteteve dhe të qeverive ranë dakord për mandatin e mbledhjes së shpejti të Konferencës Ndërqeveritare. Ky mandat është i qartë dhe i jep mundësi konferencës të mbarojë shpejt para fundit të presidencës portugeze. Kjo do të lejojë zhvillimin e zgjedhjeve të Parlamentit Evropian të Shtatorit 2009 me një bazë kontraktore të re.
2. Roli i BE-së si një element global po rritet. Kjo është ajo që njerëzit e thjeshtë kërkojnë nga politikanët dhe kjo reflektohet në punën e presidencës gjermane. Politika e Jashtme e Përbashkët dhe e Sigurisë, Politika e Mbrojtjes Evropiane u përforcuan: u vendos që të krijohet një shtab civil në sekretariatit dhe këshillit me synim bërjen më efektive të planifikimit dhe menaxhimit të misioneve civile (Afganistan, Kosovë), si dhe thejeshtimin e koordinimit mes menaxhimit të krizave civile dhe atyre ushtarake.
3. Duhet të theksohen vendimet e mëposhtme në sferën e politikës së klimës dhe energjisë: çlirimi i gazrave të dëmshme do të ulët me 20 % më 2020, ngrohja globale do të kufizohet në dy gradë, pjesa e energjive të rinovueshme në konsumin e përgjithshëm do të rritet në 20 % deri më 2020.
4. Në sferën e drejtësisë dhe punëve të brendshme, Evropa ka riafirmuar vendosmërinë e saj për të frenuar emigracionin e paligjshëm, në kontekstin e dialogut të saj me vendet e origjinës dhe atyre tranzite, ashtu si dhe përmirësimin e kuadrit për migrim të ligjshëm. Në këtë mënyrë, në të ardhmen, BE do të fokusohet jo vetëm në Mesdhe, por edhe në një shkallë më të madhe në rajonet fqinje, në lindje dhe jug-lindje.
5. Presidencja gjermane i dha prioritet kryesor fuqizimit si të dimensionit shoqëror në Evropë, ashtu dhe aftësisë konkurruese. Shembuj konkretë janë: ligji mbi çmimet roaming, i cili do ta bëjë më të lirë përdorimin e telefonave celularë në të gjithë Evropën. Zona e vetme e pagesave evropiane do tu japë mundësi bizneseve dhe qytetarëve të bëjnë pagesa në të gjithë Evropën po aq shpejt, thjesht dhe lirë sa ç'është e mundur për pagesat kombëtare. Dimensioi shoqëror i BE-së është rritur nga vendimet për koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore dhe shtytja e freskët për një politikë novatore dhe parandaluese për shëndetin.

"Presidencja gjermane ka korrur një sukses që shumë do ta kishin menduar të paimagjinueshëm para pak muajve, apo deri edhe para pak ditëve. Në emër të Evropës, unë dua t'ju jap falënderimet e mia më të përzemërta dhe pres me kënaqësi të punojmë bashkë në të ardhmen. Kjo tregon se Evropa po lëviz në drejtimin e duhur"

Barroso

Në këtë numër:

- Një ditë e mirë për Europën FAQE 3
- Bashkëpunim rajonal për energjinë FAQE 6
- Samiti i Stambollit FAQE 7
- Shqiptarët donin që Bushi... FAQE 9
- Historia e Toni Blerit FAQE 12-13
- EU INTERESANTE FAQE 15

